



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

**Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrasnjih Poslova /Ministry of
Internal Affairs**

Protokoll Shtesë

**Për Intensifikimin e Bashkëpunimit në Luftën kundër Trafikimit të
Qenieve Njerëzore dhe për Përmirësimin e Identifikimit, Njoftimit,
Referimit dhe Kthimit Vullnetar të Ndihmuar të Viktimave, si dhe
Viktimave të Mundshme të Trafikimit, në veçanti të Fëmijëve, në
plotësim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës
dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Mbi
Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar”**

Palët e Këtij Protokollit Shtesë, bien dakord për sa më poshtë:

I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

*Lidhja me Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar midis Këshillit të
Ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Republikës së Shqipërisë.*

1. Ky Protokoll Shtesë plotëson *Marrëveshjen mbi Bashkëpunimin Policor Ndërkufitar (neni 25) midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, nënshkruar në Prishtinë, më datë 06.10.2009 (që këtu e tutje e referuar si “Marrëveshja”). Ky Protokoll Shtesë interpretohet së bashku me Marrëveshjen;*

2. Dispozitat e Marrëveshjes zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur thuhet shprehimisht ndryshe në këtë Protokoll;
3. Ky Protokoll Shtesë trajton në mënyrë të veçantë çështje që kanë të bëjnë me trafikimin e fëmijëve, duke marrë në konsideratë faktin që fëmijët e pashoqëruar përbëjnë kategorinë më të rrezikuar nga trafikimi dhe kanë nevojë për mbrojtje dhe kujdes të veçantë;
4. Në kontekstin e zbatimit të këtij Protokoll, pëlqimi i fëmijës viktimë e trafikimit nuk merret parasysh në asnjë rast të dyshuar si trafikim i qenieve njerëzore.

Neni 2

QËLLIMI

Protokoll Shtesë synon të rrisë bashkëpunimin midis Autoriteteve Përgjegjëse të Palëve nënshkruese të këtij Protokoll dhe strukturave të tjera shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me qëllim:

- a. Intensifikimin e përpjekjeve të të dy palëve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore në përgjithësi dhe trafikimit të fëmijëve në veçanti;
- b. Intensifikimin e shkëmbimit të informacionit dhe bashkëpunimit midis tyre, si dhe ndihmën reciproke për sa i përket identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit, si dhe kthimin e ndihmuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, përfshirë edhe hetimin e trafikantëve me veprimtari në të dy vendet;
- c. Forcimin e bashkëpunimit reciprok midis strukturave të zbatimit të ligjit nga të dy palët në zbatim të marrëveshjes dhe të akteve të tjera ndërkombëtare si: Protokollin për Parandalimin, Kufizimin dhe Dënimin e Trafikimit të Qenieve njerëzore, sidomos atij të Grave dhe Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar, si dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore;
- ç. Ndërtimin dhe formalizimin e bashkëpunimit midis të dy palëve për t'iu përgjigjur nevojave dhe tendencave të reja të trafikimit dhe shfrytëzimit të qenieve njerëzore;
- d. Shkëmbimin e eksperiencave pozitive dhe, sa të jetë e mundur, unifikimin e praktikave, procedurave dhe metodologjisë së punës në drejtim të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore për të gjitha aspektet, si për hetimin e rasteve, ashtu edhe për identifikimin, referimin, kthimin e ndihmuar dhe mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
- dh. Caktimin e personave të kontaktit në Autoritetet Përgjegjëse respektive të përcaktuara sipas këtij Protokoll për administrimin dhe mbikëqyrjen e bashkëpunimit sipas mënyrave të përcaktuara në Nenin 5 të këtij Protokoll, dhe

sa herë që është e nevojshme, për të ndihmuar në zgjidhjen e rasteve apo problemeve specifike.

Neni 3

PËRKUFIZIME

Termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a. "Trafikim i qenieve njerëzore" është rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose të gjendjes së dobët, ose të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin. Shfrytëzimi përfshin, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës apo shërbimeve të detyruara, skllavërimin ose formave të tjera të ngjashme me skllavërimin, robërimin ose heqjen e organeve;
- b. "Trafikimi i fëmijëve" është rekrutimi, transporti, transferimi, fshehja, shitja apo marrja e një fëmije me qëllimin e shfrytëzimit edhe në ato raste kur nuk përfshin ndonjë nga mënyrat e parashtruara në pikën (a) të këtij neni;
- c. "Viktimë e trafikimit" nënkupton personin fizik që është objekt i trafikimit të qenieve njerëzore sipas përkufizimit në nenin 4, pika "e" e Konventës së Këshillit të Evropës, "Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore";
- d. "Fëmijë, viktimë e trafikimit" është çdo person i lindur gjallë deri në moshën 18 vjeç, kundër të cilit është kryer akti i trafikimit siç përcaktohet në nenin 3/b. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është një fëmijë, ky person duhet të konsiderohet si i tillë dhe përfiton nga ky Protokoll derisa mosha e personit të përcaktohet plotësisht;
- e. "Viktimë e mundshme e trafikimit" është çdo person fizik i cili identifikohet si i tillë në bazë të kritereve të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm i secilës palë duke marrë në konsideratë edhe zbatimin e akteve ndërkombëtare në të cilat palët bëjnë pjesë;
- f. "Fëmijë-viktimë e mundshme e trafikimit" do t'i referohet fëmijës që ndodhet në një situatë serioze, konkrete dhe aktuale, si rezultat i së cilës fëmija ballafaqohet me rrezikun e trafikimit;
- g. Pëlqimi i viktimit të trafikimit për shfrytëzimin e qëllimshëm të parashtruar në pikën (a) të këtij neni, nuk merret parasysh në rastin e përdorimit të mjeteve të parashtruara në pikën (a) të këtij neni. Pëlqimi indirekt ose real i fëmijës është i papranueshëm;

- h. "Fëmijë të pashoqëruar" do të nënkuptojmë personin nën 18 vjeç, i cili jeton në territorin e një prej palëve nënshkruese të këtij Protokoll, i ndarë nga prindërit dhe jo nën kujdestarinë e një të rrituri.

II

FUSHA E ZBATIMIT

Neni 4

FUSHA E ZBATIMIT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE TË PALËVE NË KËTË PROTOKOLL SHITESË

1. Ky Protokoll zbatohet për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, duke qenë me natyrë ndërkuftare, pavarësisht nga fakti nëse ka apo jo lidhje me krimin e organizuar.

2. Autoritete Përgjegjëse për zbatimin e këtij Protokoll janë:

Për Republikën e Kosovës:

- Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë:

- Zyra e Koordinatorit Nacional për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz

Neni 5

FUSHAT DHE MËNYRAT E BASHKËPUNIMIT

Autoritetet Përgjegjëse të caktuara nga secila palë në këtë Protokoll, do të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre, më konkretisht duke:

- a) shkëmbyer rregullisht informacione me anë të të cilave do të bëhet i mundur parandalimi, zbulimi, dokumentimi i veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore që kryhen midis palëve. Ky shkëmbim informacioni do të realizohet, të paktën, çdo javë, dhe nëse e kërkojnë rrethanat, menjëherë. Informacioni për rastet e identifikuar do të përmbajë të gjitha të dhënat e duhura për të mundësuar një hetim të suksesshëm dhe profesional si dhe një identifikim, referim dhe mbrojtje sa më të sigurt dhe në interesin më të lartë të viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit; Autoritetet Përgjegjëse të të dy vendeve janë përgjegjëse për hartimin e një formati për shkëmbimin e informacionit dhe mënyrën e shkëmbimit të tij, format i cili është pjesë e aneksit të këtij Protokoll.

- b) marrë masa konkrete me veprime të përbashkëta me qëllim parandalimin e trafikimit dhe shfrytëzimit, si dhe mbulimin e një fushe sa më të gjerë të nevojave, tendencave dhe specifikave të ndryshme të fenomenit. Shkëmbimi i informacionit nuk do të kufizohet vetëm për rastet e trafikimit por edhe për situata të tjera, sidomos të rasteve të fëmijëve dhe grave të shfrytëzuara apo në situatë të rrezikuar nga trafikimi;
- c) ndihmuar njëri-tjetrin, në të njëjtën mënyrë të shprehur më lart, në analizimin e informacionit që u përket fushave të renditura në Nenin 5 (a dhe b) të këtij Protokollit Shtesë dhe lehtësimin e shkëmbimeve midis ekspertëve të tyre përkatës në mënyrë të vazhdueshme;
- d) organizuar takime të ekspertëve në nivel qendror nga Autoritetet e caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokollit Shtesë, çdo gjashtë muaj, për të rishikuar zbatimin e këtij Protokollit Shtesë; takime të planifikuara dhe, sipas nevojës, takime lokale, për zgjidhjen e çështjeve operative urgjente, rasteve të veçanta ose problemeve që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore, ose me identifikimin, njoftimin, referimin dhe kthimin e ndihmuar të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit;
- e) siguruar zbatimin e plotë nga ana e Policive përkatëse ose Shërbimeve Sociale Shtetërore, të dispozitave të Marrëveshjes dhe protokolleve shtesë midis Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dhe të Protokollit për Parandalimin, Kufizimin dhe Dënimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, sidomos të Grave dhe Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Autoritetet Përgjegjëse të palëve nënshkruese të këtij protokollit do të kenë në vëmendje të veçantë: kërkesat e njoftimit, referimit, mbrojtjes dhe kthimit të ndihmuar në territoret e tyre përkatëse të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit; shëndetin, moshën, mirëqenien dhe nevojat e këtyre personave për mbrojtje; të drejtat e tyre sipas instrumenteve përkatës ndërkombëtarë për periudhën e reflektimit, qëndrimin apo zhvendosjen e përhershme ose të përkohshme; si dhe nevojën për bashkëpunim tërësor për hetimin në kohë të rasteve të tilla.

III

VEPRIMET KRYESORE PËR IDENTIFIKIMIN, REFERIMIN, MBROJTJEN DHE KTHIMIN VULLNETAR TË ASISTUAR TË VIKTIMAVE/VIKTIMAVE TË MUNDSHME TË TRAFIKIMIT

Neni 6

Identifikimi dhe referimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

1. Autoritetet Përgjegjëse të Palëve sipas këtij Protokollit marrin përsipër identifikimin dhe referimin në kohë dhe sipas standardeve të parashikuara në legjislacionin e tyre të brendshëm të gjitha viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit për shtetasit e Kosovës dhe Shqipërisë;
2. Procesi i identifikimit do të zhvillohet duke u bazuar në sistemin dhe mekanizmat formal të identifikimit të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të parashikuar në legjislacionin e brendshëm të palëve;

3. Për rastet e fëmijëve viktimë/viktima të mundshme të trafikimit palët do të zbatojnë procedura efektive për identifikimin e menjëhershëm të tyre. Policia, shërbimet sociale, shërbimet e kujdesit shëndetësor, institucionet arsimore, autoritetet lokale, Organizatat Ndërkombëtare dhe joqeveritare apo aktorë të tjerë, sapo të vihen në dijeni të një rasti të tillë do të njoftojnë menjëherë autoritetin përgjegjës të vendit të tyre, i cili do të vijojë me masat e duhura për marrjen e rastit në mbrojtje, përfshirë edhe njoftimin e Autoritetit Përgjegjës të Palës tjetër;
4. Për sa të jetë e mundur, palët do të unifikojnë procedurat e tyre të identifikimit dhe referimit të rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim aplikimin e standardeve më të mira, duke patur gjithmonë në qendër të vëmendjes interesin më të lartë të viktimës;
5. Për të gjitha rastet e identifikuara autoritetet përgjegjëse të Palëve do të krijojnë dosje të veçantë për çdo person të identifikuar si viktimë/viktimë të mundshme e trafikimit. Autoriteti Përgjegjës i Palës që kryen identifikimin fillestar të rastit cakton një Menaxher Rasti. Në bashkëpunim me organet e tjera të përcaktuara në nenin 7, pika 3, Menaxheri i Rastit kryen një analizë të riskut dhe nevojave të rastit si dhe harton planin e veprimit dhe të asistencës së rastit.

Neni 7
Njoftimi paraprak

1. Palët në këtë Protokoll shtesë bien dakord që të njoftojnë paraprakisht njëra tjetrën për të gjitha rastet e identifikuara të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimi kur ata janë shtetas të palës tjetër;
2. Njoftimi paraprak bëhet menjëherë sapo autoritetet e shtetit pritës të kenë arritur në konkluzionin se kanë të bëjnë me një viktimë/viktimë të mundshme trafikimi, por jo më vonë se 7 ditë nga momenti i konstatimit/identifikimit të një viktime trafikimi;
3. Për rastet e identifikuara ku viktimë/viktima të mundshme të trafikimit janë fëmijët, njoftimi duhet të jetë i menjëhershëm, me qëllim që të sigurohet edhe informimi i prindit apo kujdestarit ligjor të fëmijës;
4. Pas njoftimit paraprak shteti i origjinës do të marrë të gjitha masat për vlerësimin e rrezikut dhe sigurimin e kushteve për kthimin vullnetar të ndihmuar të viktimës;
5. Njoftimi paraprak do të bëhet nëpërmjet pikave të kontaktit të përcaktuar në këtë Protokoll Shtesë. Informacioni do të përcillet nëpërmjet mjeteve të sigurta për të cilat palët kanë rënë dakord paraprakisht;
6. Informacioni i rastit, është dokumentacioni shoqërues i rastit dhe i përcillet Autoritetit Përgjegjës të Palës tjetër.

Neni 8

Kthimi vullnetar i asistuar i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

1. Në zbatim të këtij protokolli shtesë palët marrin masat e duhura për të lehtësuar kthimin vullnetar të ndihmuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit në një kohë sa më të arsyeshme dhe duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë dhe mbrojtjes sociale të viktimës;
2. Pas marrjes së njoftimit paraprak dhe kërkesës për kthim vullnetar të viktimës së trafikimit, palët duhet të koordinojnë veprimet dhe bashkërisht të përgatisin një plan masash që ka të bëjë kryesisht me shtetësinë, pajisjen me dokumentet e duhura të identitetit, analizën e rrezikut, përcaktimin e ambientit të referimit, si dhe masa të tjera në lidhje me transportin e sigurt të viktimës së trafikimit etj.
3. Në rastin e kthimit të viktimës pranë familjes dhe sidomos kur viktimë është fëmijë bëhet një analizë më e plotë social-ekonomike e familjes si dhe krijohen kushtet e përshtatshme për akomodim pranë familjes;
4. Në rastin kur pas analizës së rrezikut ka rezultuar apo dyshohet se pjesëtarë të familjes apo kujdestari ligjor janë të përfshirë në trafikim, atëherë merren masat e duhura për akomodim në një qendër të veçantë për trajtimin e fëmijëve në vendin e origjinës. Në raste të veçanta të diktuara nga rreziku që i kanoset fëmijës në vendin e origjinës, apo si rezultat i nevojave të tij, fëmija duhet të trajtohet aty ku ndodhet sipas vendimit të Autoritetit Përgjegjës përkatës.
5. Ky Protokoll Shtesë nuk bie ndesh me Marrëveshjen Dypalëshe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë "Për Ripranimin e Personave" dhe protokollit shtesë të saj.

Neni 9

Mbrojtja e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit

1. Në zbatim të këtij Protokolli Shtesë Palët angazhohen se do të marrin të gjitha masat për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit sipas standardeve të ngritura dhe të aplikuara për viktimat e trafikimit;
2. Autoritetet Përgjegjëse të Palëve, brenda kompetencave dhe kuadrit ligjor të brendshëm, në lidhje me viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për:
 - a. qëndrimin në territoret e tyre përkohësisht ose përgjithmonë sipas nevojave të rastit dhe në interesin më të lartë të viktimës;
 - b. pajisjen me dokument identiteti, leje qëndrimi (të përkohshme/afatgjatë) për viktimat/viktimat e mundshme shtetas të palës tjetër, të cilët për arsye të ndryshme (reflektimi, rehabilitimi, riatdhesimi, apo për të bashkëpunuar

- me organet e drejtësisë) dëshirojnë të qëndrojnë në territorin e shtetit pritës;
- c. ofrimin e shërbimeve në mënyrë të pakushtëzuar nga bashkëpunimi me organet e drejtësisë;
 - d. intervistimin nga një grup i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme dhe plotësimin e nevojave të veçanta që kanë të bëjnë me shëndetin, ushqimin, strehimin, arsimimin, sigurinë etj.
3. Për plotësimin e të gjitha nevojave dhe shërbimeve të ndryshme, Autoritetet Përgjegjëse bashkëveprojnë me njëra-tjetrën dhe bashkëpunojnë me agjenci dhe struktura të tjera që ofrojnë shërbime për viktimat e trafikimit brenda vendit të tyre.

IV KOMUNIKIMI MIDIS PALËVE TË KËTJË PROTOKOLLI SHITESË

Neni 10

1. Palët në këtë Protokoll Shtesë bien dakord për mjetet dhe për mënyrën e shkëmbimit të informacionit si dhe caktojnë personat e kontaktit, të cilët do të veprojnë në emër të Autoriteteve Përgjegjëse për zbatimin e këtij Protokoll Shtesë.
2. Secili nga Autoritetet Përgjegjëse të caktuara nga palët sipas këtij Protokoll Shtesë, brenda 1 muaji (30 ditëve) nga nënshkrimi i tij, do të caktojë një pikë kontakti (duke detajuar emër/mbiemër, funksionin dhe kontaktet përkatëse) me qëllim që të sigurohet efikasiteti në vazhdimësi i bashkëpunimit të tyre në shkëmbimin e informacionit, çështjeve operative dhe gjatë procesit të identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit.
3. Komunikimi midis Autoriteteve të caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokoll Shtesë dhe personave të emëruar të kontaktit kryhet në gjuhën shqipe apo në çfarëdo gjuhe tjetër, në bazë të marrëveshjes së Palëve.
4. Për të siguruar një bashkëpunim sa më efikas dhe gjithëpërfshirës palët angazhohen që të krijojnë hapësirat e duhura dhe të ftojnë për të dhënë ndihmesën e tyre në këtë bashkëpunim dhe përfaqësues të Prokurorive të të dy vendeve.

V MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 11

1. Informacioni i dhënë në bazë të këtij Protokoll Shtesë konsiderohet konfidencial dhe përdoret vetëm nga Autoritetet e caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokoll Shtesë, dhe vetëm për arsye të qëllimeve të përmendura, dhe nuk i komunikohet apo përcillet

një shteti të tretë, me përjashtim të rasteve kur ka miratim me shkrim nga Autoriteti i caktuar Përgjegjës nismëtar, sipas këtij Protokoll Shtesë.

2. Autoritetet e caktuara Përgjegjëse, sipas këtij Protokoll Shtesë, garantojnë mbrojtjen e të dhënave të fshehta, të marra në zbatim të dispozitave të këtij Protokoll Shtesë, në përputhje të plotë me legjislacionin e tyre kombëtar.
3. Autoritetet e caktuara Përgjegjëse, garantojnë që fshirja ose shkatërrimi i çdo lloj të dhëne apo informacioni të marrë në zbatim të dispozitave të këtij Protokoll Shtesë, do të kryhet në përputhje të plotë me legjislacionin e tyre kombëtar.

VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 12

Zgjidhje e Mosmarrëveshjeve

Çdo lloj mosmarrëveshje rreth interpretimit ose zbatimit të këtij Protokoll Shtesë, zgjidhet me anë të konsultimeve midis Autoriteteve të caktuara Përgjegjëse sipas këtij Protokoll, në kuadër të takimeve të përbashkëta që parashikohen në Nenin 5 (d) të këtij Protokoll.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky Protokoll Shtesë hyn në fuqi ditën e 30-të pas datës së nënshkrimit të tij nga ana e Autoriteteve të caktuara Përgjegjëse, sipas këtij Protokoll Shtesë.

Nënshkruar në *Prishtinë*....., më *12.06.2012*....., në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze ku të gjitha tekstet janë një lloj autentike. Në rast të mosmarrëveshjeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR

PËR

MINISTRINË E PUNËVE TË BRENDSHME TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

MINISTRINË E BRENDSHME TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

COORDINATORI NACIONAL PËR
ANTITRAFIKIMIN

COORDINATORI KOMBËTAR PËR
ANTITRAFIKIMIN